



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04
Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 2 gusht 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit për Parashtrime në lidhje
me Rishikimin e Paraburgimit**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 9(5)(a) dhe (6) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 22 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Pjetër Shalës (“z. Shala”) (“Vendimi mbi Paraburgimin”).² Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi z. Shala që të dorëzonte, nëse dëshironte, parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, jo më vonë se te hënën, 1 gusht 2022, ose të paraqesë përgjigje ndaj parashtrimeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) jo më vonë se të hënën, 15 gusht 2022.³

2. Më 27 korrik 2022, Mbrojtja e z. Shala (“Mbrojtja”) dorëzoi kërkesën për zgjatje të afatit për paraqitje të parashtrimeve në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit (“Kërkesa”).⁴ Në veçanti, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të lejojë parashtrimin e përgjigjes së vet ndaj parashtrimeve të ZPS-së në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të z. Shala, në çdo kohë që gjykohet e përshtatshme pas dorëzimit të dosjes paraprake të Mbrojtjes, që duhet të dorëzohet deri më 5 shtator 2022.⁵ Mbrojtja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit që kërkohet, sepse ajo aktualisht po përballet me një numër detyrimesh procedurale paralele, si detyrimi për të treguar nëse ka

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00224, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 22 qershor 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00224/RED.

³ Vendimi mbi Paraburgimin, para. 55(b)-(c).

⁴ KSC-BC-2020-04, F00240, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit për Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit*, 27 korrik 2022, publike.

⁵ Kërkesa, para. 2, 6.

kundërshtime lidhur me pranueshmërinë e materialit provues dhe për të dorëzuar dosjen e vet paraprake.⁶ Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se është duke shqyrtuar materialin e nxjerrë së fundi nga ZPS-ja, duke vazhduar me një numër kundërshtimesh lidhur me drejtësinë e procesit dhe duke i përfunduar hetimet e saj.⁷

3. Më 1 gusht 2022, Mbrojtja paraqiti një plotësim në Kërkesën e saj, ku konfirmoi se z. Shala heq dorë, për një periudhë pesëjavore, nga e drejta për rishikimin e paraburgimit deri më 22 gusht 2022 (“Parashtrimi Plotësues i Kërkesës”).⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri kur aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirim, pasi të kenë kaluar dy muaj nga vendimi i fundit për paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerrin aktvendim për lirim apo përfundimin e paraburgimit.

5. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë, *proprio motu*, çdo afat të përcaktuar prej Rregullores ose prej Panelit.

6. Në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare, vendimi mbi një kërkesë për ndryshimin e afatit mund të merret pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

⁶ Kërkesa, para. 3-4.

⁷ Kërkesa, para. 4-5.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00244, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrim në Mbështetje të Kërkesës për Zgjatje të Afatit për Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me Rishikimin e Ardhsëm të Paraburgimit*, 1 gusht 2022, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale.

III. DISKUTIM

7. Pasi ka shqyrtuar arsyet e paraqitura nga Mbrojtja, në veçanti detyrimet procedurale paralele, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se janë treguar arsye të vlefshme që përlligjin zgjatjen e kufizuar të afatit. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vë në dukje se z. Shala ka hequr dorë nga e drejta për rishikim të paraburgimit para përfundimit të afatit dymujsh të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.⁹ Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gjatë ndryshimit të afatit për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, mban parasysh afrimin e afatit të kalimit të dosjes për gjykim më 21 shtator 2022.¹⁰

8. Duke pasur parasysh se zgjatja e kufizuar e afatit do të ishte gjithashtu e dobishme për parashtrimet e ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nxjerrja e vendimit aktual para dorëzimit të përgjigjes së ZPS-së në lidhje me Kërkesën, nuk ka shkaktuar dëm.

IV. VENDIM

9. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

(a) **MIRATON** Kërkesën;

(b) **URDHËRON** Mbrojtjen që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime për rishikimin e paraburgimit të z. Shala, jo më vonë se të **premtën, 22 gusht 2022**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afatit të përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores; dhe

(c) **URDHËRON** ZPS-në që, në qoftë se z. Shala vendos të mos dorëzojë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të dorëzojë parashtrime për

⁹ Shtojca 1 e Parashtrimit Plotësues të Kërkesës.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00234, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 20 korrik 2022, konfidencial, para. 46(f).

rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **të hënën, 5 shtator 2022**, dhe që z. Shala, nëse dëshiron, të dorëzojë përgjigje jo më vonë se **të hënën, 12 shtator 2022**.

 /nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 2 gusht 2022
Në Hagë, Holandë.